



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr. 615/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Valentina Alijaj, anëtare për Kuvendin Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**REFUZOHEN** si të pabazuara apelet e parashtruar nga Valentina Alijaj, anëtare për Kuvendin Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me shenjën ZL.Anr.615/2017, ZL.Anr.616/2017, ZL.Anr.617/2017 dhe ZL.Anr.618/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

#### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar apelet ZL.Anr.615/2017, ZL.Anr.616/20147, ZL.Anr.617/2017 dhe ZL.Anr.618/2017 me datën 09.11.2017, nga Valentina Alijaj, anëtare për Kuvendin Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik NISMA, në të cilën thekson se në vendvotimet 0202x/18R, 0202x/21D, 0213C/04D, 0228C/01R dhe 0223c/02R, gjatë numërimit dhe klasifikimit në FRK kanë figuruar por gjatë rinumërimit dhe publikimit të rezultateve i mungojnë votat.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.615/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për tri apelet që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, dhe për ato apele të vendoset me një vendoset me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apelet janë të pabazuara**

Paneli pretendimet ankimore të parashtrueses së apelit i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për arsye se gjatë hetimit të bërë nga ekipi hetues i PZAP-it me datë 11.11.2017 në kutitë e votimit: 0202x/18R, 0202x/21D, 0213C/04D, 0228C/01R dhe 0223c/02R në QNR, konstatoi se në vendvotimet 0202x/18R, 0202x/21D, 0213C/04D, 0228C/01R dhe 0223c/02R në QNR nuk ka pasur ndryshim të votave nga numri i votave të shpallura me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 2232-2017 të datës 08.11.2017 .

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase pretendimet e parashtruesit të apelit sipas hetimit të bërë nga PZAP, nuk qëndrojnë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**  
ZL.Anr.615/2017 më datën 12.11.2017.

**Kryesuese e Panelit**  
**Gyltene Sylejmani**



### ***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*